

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 25 / 10 / 2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI: Z. Asllan TROKSI, i lindur më 25.02.1958, në Surrel, shtetas Shqiptar, me adrsesë Rruga Nacionale Tiranë-Dajt, Njesia Administrative Dajt, Fshati Surrele, Banese Private nr. 07, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Numër personal F80225116V, madhor.

DHE

BLERËSI: Shoqëria SUPERIOR GROUP shpk, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT K91712015L, me seli në adresën Farkë SAUK, Autostrada Tiranë - Durrës, Zona Kadastrale nr. 3266, përfaqësuar nga administrator **Altion Memushi** i datëlindjes 29.03.1973 identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal H30329070G.

OBJEKTI: Shitja e 83,037 (tetëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksionari **Z. Asllan TROKSI** dhe blerja e tyre nga aksionari shoqëria **SUPERIOR GROUP shpk**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencen nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 83,037 (tetëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë) aksione të shiten me një çmim 1.686 euro/aksion, me çmimin total prej 140,000.38 (njëqind e dyzetë mijë pikë tridhjetë e tetë) euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE



- **Shitësi** është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 83,037 (tetëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.
- Nga ana e tij **Blerësi, Shoqëria SUPERIOR GROUP shpk**, është plotësisht dakord të blejë 83,037 (tetëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, të zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të Bankës.
- Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 140,000.38 (njëqind e dyzetë mijë pikë tridhjetë e tetë) euro nga ana e Blerësit shoqëria **SUPERIOR GROUP shpk**, në llogarinë e Shitësit **Z. Asllan TROKSI**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Asllan TROKSI

Asllan Troksi
Asllan

BLERËSI

Shoqëria SUPERIOR GROUP shpk

Përfaqësuar nga

Administratori

Altion MEMUSHI

Altion Memushi
